



## KOLEGJI UNIVERSITAR "QIRIAZI"

Adresa: Kodër - Kamëz, Tiranë. www.qiriazi.edu.al , Tel/Fax: ++355 47 200 111; Mob. ++355(0)69 40 94 516

### **KRITERET PËR PRANIMIN E KANDIDATËVE TË KOLEGJIT UNIVERSITAR "QIRIAZI" PËR VITIN AKADEMIK 2026 – 2027**

#### **1. PËR FAKULTETIN EKONOMIK**

Kriteret e pranimit të studentëve në programet e studimit për të dy Ciklet, që ofrohen nga Kolegji Universitar "Qiriazi", për vitin akademik 2026 - 2027 janë:

##### **A. Programi i studimit i Ciklit të Dytë Master i Shkencave në**

**"Administrim Biznesi" dhe "Financë (në gjuhën shqipe):**

- Nota mesatare nga studimet Bachelor (25%)
- Diploma Bachelor nga degë të ngjashme në fushën e ekonomisë (60%)
- Intervista me kandidatët (15%).

**Për programin Financë:** Në rastet kur studenti zotëron një diplomë Bachelor nga degë të përafërta, për të cilat vërehet mangësi në formimin e studentit me njohuri të nevojshme nga fusha e financës/kontabilitetit, rekomandohet që studenti të ndjekë një sesion të veçantë intensiv në lëndët e poshtëshënuara:

- Financë
- Kontabilitet

##### **B. Programi i studimit i Ciklit të Dytë - Master i Shkencave në: "Administrim Biznesi" (në gjuhën angleze).**

1. Kandidati të ketë përfunduar studimet në fusha të ngjashme, në një program studimi të Ciklit të Parë, brenda dhe jashtë vendit, e vlerësuar nga ministria përgjegjëse si ekuivalente me të dhe që plotëson kriterin/kriteret shtetërore, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
2. Në rastet e aplikimit për një program të dytë studimi kandidati zotëron një diplomë universitare të lëshuar nga një institucion i Arsimit të Lartë, në Shqipëri apo jashtë vendit.
3. Nëse studentit ka përfunduar studimet në fusha të ngjashme në një program të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në gjuhë angleze, atij mund t'i njihen kredite të këtij programi, me qëllim transferimin e tyre në programin e studimit "Master i Shkencave".



**C. Programet e studimit të Ciklit të Parë - Bachelor në “Menaxhim Biznesi” (në gjuhën shqipe dhe angleze), “Financë” (në gjuhën shqipe), “Menaxhim Hoteleri - Turizëm” (në gjuhën shqipe):**

- Nota mesatare e shkollës mesme, përfshirë provimet e maturës shtetërore, sipas VKM, nr. 436, datë 03.06.2020, të jetë mbl 6.5 (50%).
- Mesatarja e lëndëve që lidhen me formimin në fushën e aplikimit (35%).
- Intervistë me kandidatët (15%).

**Për kandidatët që ndjekin studimet në Ciklin e Parë në “Menaxhim Biznesi gjuhë angleze kërkohet:**

- Njohja e gjuhës angleze të ketë certifikimin dhe rezultatin e testeve ndërkombëtare sipas kriterëve të përcaktuar nga aktet nënligjore në fuqi. Nga ky kriter, përfshihen kandidatët, të cilët kanë ndjekur studimet dhe që zotërojnë një diplomë në këtë gjuhë.
- Posedimi i një diplome universitare të lëshuar nga një institucion i Arsimit të Lartë, në Shqipëri apo jashtë vendit, në rastet e aplikimit për një program të dytë studimi

**2. PËR FAKULTETIN E DREJTËSISË**

Kriteret e pranimit të studentëve në programet e studimit për të dy ciklet, që ofrohen nga Kolegji Universitar “Qiriazi”, për vitin akademik 2026 - 2027 janë:

**A. Master i Integruar në Drejtësi:** Pranohet çdo kandidat, që ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë, minimalisht me notë mesatarë 6.5 (gjashtë pikë pesë) sipas vendimit të Këshillit të Ministrave.

1. Nevojitet dokumenti i njohjes së një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht e spanjisht, të jetë ndërmjet nivelit B1 dhe nivelit B2, sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimit në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë” të MAS,;
2. Në rastet e transferimit të studimeve nga brenda apo jashtë vendit, në vitet e ndërmjetme të programit të studimit, studentët duhet të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me VKM.

**B. Programi me karakter profesional “Asistent Ligjor dhe Administrativ”.** Pranimi në programin e studimit i çdo kandidat që ka përfunduar me sukses maturën shtetërore. **Nota mesatare nuk është kriter pranimi**, si dhe përfshihen nga detyrimi i plotësimit të kriterit të notës mesatare kandidatët me origjinë shqiptare nga Republika e Kosovës, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci.



### 3. PËR FAKULTETIN E EDUKIMIT, SHKENCAVE SOCIALE DHE SPORTIT

Referuar niveleve 6-7 të KShK, si dhe programeve të studimit me karakter profesional referuar nivelit 5 të KShK kriteret e pranimit të studentëve në programet e studimit për të dy Ciklet, për vitin akademik 2026 - 2027 janë:

- A. Në programin e studimit Bachelor në **“Edukim Fizik dhe Sporte”** pranohen kandidatë që kanë përfunduar me sukses maturën shtetërore dhe plotësojnë kriterin e notës mesatare sipas VKM- së në fuqi.
1. Kandidatët do të nënshtrohen **konkurimit sportiv praktik (Cirkuitit fiziko koordinativ)** sipas testeve të miratuara nga Senati Akademik i Kolegjit Universitar “Qiriazi” (KUQ).
  2. Kandidatët që do konkurojnë duhet të kenë gjendje shëndetësore të mirë të dëshmuar përmes raportit mjeko -ligjor, lëshuar nga qendra shëndetësore përkatëse e kandidatit.
  3. Kandidatët do të vlerësohen sipas pikëve të grumbulluara nga **shuma e pikëve të notës mesatare dhe pikëve të fituara në cirkuitin fiziko koordinativ (50% me 50%)**.
  4. Renditja e kandidatëve bëhet bazuar në sasinë totale të pikëve të grumbulluara në rendin zbritës.
- B. Në programin e studimit me karakter profesional, 2 vjeçar **“Kujdes Social dhe Shëndetësor”** për vitin akademik 2026-2027 pranohen kandidatët që kanë përfunduar me sukses maturën shtetërore. **Nota mesatare nuk është kriter pranimi.** Renditja e kandidatëve bëhet bazuar në notën mesatare të maturës shtetërore të kandidatit.
4. Në Kolegjin Profesional të Lartë kriteret e pranimit të studentëve në programet e studimit profesional 2-vjeçar, në **“Teknologji Ushqimore”, “Hoteleri-Turizëm”, “Teknologji Informacioni”**, referuar niveleve 5 të KShK, për vitin akademik 2026- 2027 që kanë përfunduar me sukses maturën shtetërore. **Nota mesatare nuk është kriter pranimi.** Renditja e kandidatëve bëhet bazuar në notën mesatare të maturës shtetërore të kandidatit.

